# S T A T U T

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR " EURON " TIRANE

## F O R M I M I

### ARTIKULLI 1

Formohet shoqeria me pergjegjegjesi te kufizuar " EURON " e cila krijohet mbi bazen e inisiatives se lire dhe kaiptalit te ortakeve : 1. Gezim Gela , i biri;i Sokolit dhe i Mahrijes , i dt? I964, lindur ne Kukes dhe banues ne Tirane nr rrugen " Maliq Musa" P. 1 shk. 1 ap. 4 me leternjoftimin e tij personal QH NR. 395462 dhe 2. Kujtim Shpata , i biri Rushitet dhe i Lumturise , i dt. I969 , lindur dhe banues ne Patos , lag: Kuqar banesa NR. 99 .

## S E L I A

### ARTIKULLI 2

Selia e SH.P.K. " EURON " do te jete ne Tirane ne rrugen "Maliq Musa " P. 1 shk. 1 ap. 4 .

Shoqeria mund te hape edhe vend- qendrime te tjera te dyta , operative filiale , perfaqesi dhe dege te tjera ne te gjithe territorin e Republike se Shqiperise dhe jashte saj, me miratimin e organeve kompetente shtetror perkatese te vendit perkates dhe sipas legjislacionit te vendit ku ato ha hen.

## KOHE- ZGJATJA

### ARTIKULLI 3

Kohe- zgjatja e shoqerise eshte e papercaktuar dhe mund te shperbehet ne çdo kohe

## O B J E K T I

### ARTIKULLI 4

Objekti i veprimtarise ekonomike te shoqerise private me pergjegjesi te kufizuar " Euron " Tirane do te jete ;

Te zhvilloje veprimtari private ne sferen e ndertim montimit per nder- time civile , indsutriale , turistike , bujqesore , etj . e kompletim me instalimet e nevojshme per te , si dhe per punimet e dheut , murature , beton , b/ arme te zakonshme , punime shembjesh dhe punime restaurimi ne perputhje me licensen e leshuar nga minsitria e Ndertimit e rregullimit te Teritorit me numer licanse Z. 0462 dt. 2.9.I993.

### A R T I K U L L I 5

Shoqeria mundet te ndryshoje emertimin , seline dhe objektin e veprim

## KAPITALI THEMELTAR

### ARTIKULLI 6

Shoqeria ka nje kapital themeltar prej 100.000 leke , me kontribut te barabarte te te dy ortakeve , secilli respektivisht nga 50.000 leke. Kapitali mund te transferohet ose te lihet peng ne perputhje me dispozitat ne fuqi, ai mund te transferohet ne rruge trashigimie.

Bashkeshortet , paraardhesit ose pasardhesit mund te behen ortake te shoqerise peperajet transferimit te pjeseve te kapitalit themeltar. Kapitali mund te shtohet me deshiren dhe sipas vendimeve te asamblese se ortakeve.

## DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

### ARTIKULLI 7

Shoqeria private me pergjegjesi te kufizuar " Euron " ne Tirane eshte prone e ortakeve Gesim Cela dhe Kujtim Shpata , te cilet qeverisin veprimtarine e saj , duke u mbeshtetur ne te drejten e tyre te pronesise private dhe te mjeteve te investuara ne shoqeri.

Zoti Gesim Celeshte caktuar administrator i shoqerise , ndersa zoti Kujtim Shpata do te jete drejtor ekzekutiv i saj.Drejtori ekzekutiv i shoqerise do te kete si funsion te tij ne shoqeri qe te udheheq dhe te drejtoje e te kontrollojne te gjithe organizimin e punes brenda shoqerise ne te gjithe proceset e ndertimit dhe te montimit , qe do te ndermarre shoqeria ne veprimtarine e saj te perditeshme.

### ARTIKULLI 8

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te ketij statuti si dhe ato te legjislacionit shqiptar ne fuqi.

SH.P.K. Euron " Tirane fiton zotesine per te vepruar me rregjistrimin e saj ne gjykaten e rrethit te Tiranes ,ne rregjistrin e saj tregetar ndersa e ushtron aktivitetin e saj tregetar me rregjistrimin e saj ne organin perkates tatimor te pushtetit .

### ARTIKULLI 9

Shoqeria ka vulen e saj me permbajtje " SH.P.K. " Euron " Tirane . Te drejten e perdorimit te vules e kane ortaket e shoqerise si dhe personat e autorizuar prej tyre.

### ARTIKULLI 10

Shoqeria vepron me te drejten e saj te pronesise dhe merr persiper

vehtes te drejta dhe detyrime . Ajo pergjigjet vete per detyrimet e saj kontraktore dhe jashte kontraktore brenda kapitalit te saj.
Ortaket kane te mbartur rrezikun per veprimtarine e shoqerise ne nivelin e shumes se mjeteve te investuara ne shoqeri( ne kapitalin e saj)
SH.P.K. " Auron " Tirane me pronare Gezim Cela dhe Kujtim Shpate , merr vendime ne zbatim te ligjeve ne fuqi dhe sipas normave te ketij statuti , te cilat jane te detyrueshem per adminstratoret e emeruar dhe te gjithe te punesuarit ne shoqeri.

ARTIKULLI 11

Ortaket ne baze te vendimeve qe merr asambleja , emerojne adminsitrator dhe punesojen punetore te aktiviteteve te ndryshme sipas nevojave qe paraqiten .

ARTIKULLI 12

Ortaket e shoqerise dhe adminsitratoret e emeruar prej tyre jane te veshur me te gjithe fuqite per drejtimin e zakonshem dhe te jashte zakonshem te shoqerise , pa asnje kufizim, me perjashtim te kompetencave qe ligji ua jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.
Admsintratoret e emeruar mund te kryejne vete te gjithe veprimet ne emer to shoqerise. Ne marredhenie me te tretet adminsitratoret veprojne ne emer te shoqerise ne te gjithe rrethanat . Ata kane te drejten qe te kryejne te gjitha aktet qe konsiderohen te nevojshme per arrtijtjen e qellimeve te shoqerise .
Shoqeria merr persiper detyrimet qe rrjedhin nga aktet e adminsitratoreve dhe kur keto akte nuk perfshiheshin ne objektin e shoqerise . Ajo nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve , kur keta te fundit e dinin se akti i administratorit e kalonte objektin e shoqerise, ose kur te tretet nuk mund t'a injronin kete akt ne rrethanat e dhena.
Ata kane te drejte te kryejne veprime prane te gjithe zyreve shtetterore e private qe kane te bejne me garancite dhe veprimet ipotekore Ne te tilla raste administratori i autorizuar njofton dhe jep llogari para ortakeve te shqoerise.

MARREDHANIET E PUNESIMIT

ARTIKULLI 13

Marredheniet e punesimit rregullohen sipas kontrates se punes . Mosmarreveshjet e punonjesve zgjidhen me mirekuptim , ne rast te kundert palet i drejtohen per zgjidhje gjykates se rrethit. Ne rast se i punesuari eshte person fizik i heuj mosmarreveshje zgjidhet nga organi qe percaktohet ne kontraten e punes.

## ARTIKULLI 14

Ortaket caktojne administratore dhe punonjes te tjere , te cileve iu caktojne pagat dhe detyrat. Shoqeria respekton rregullat e punesimit dhe te sigurimeve shoqerore , kurse te punesuarit jane te detyruar te pranojne respektojne dhe zbatojne kete statut . Administratori nuk mund te marre cilesine e ortakut ne shoqeri, dhe as te ushtroje aktivitet kontraktor te cfare do lloji per llogari te tij dhe te te treteve. Per cdo shkelje ne kete drejtim ai pergjigjet per demet e shkaktuara.

## ARTIKULLI 15

Te gjithe te punesuarit ne shoqeri jane te detyruar te ruajne sekretin e punes se shoqerise ; sekret pune perbejne shenimet materiale ; dhe aktet , te cilat dhe ligj dhe me dispozita te vecanta jane shpallur sekret . te dhenat informative , bilance , plane e informacione mbi politike ekonomike te shoqerise , qe u jepen organeve perkatese te miratuara dhe te firmosura nga asambleja e ortakeve .

## PERFAQESIMI I SHOQERISE

## ARTIKULLI 16

Perfaqesimi i SH.P.K. " Euron " Tirana i perket ortakeve te shoqerise si dhe administratoreve te emeruar prej tyre. Ata kane te drejte te perfaqesojne shoqerine edhe ne organet gjyqesore e gjykime , te caktojne dhe te pushojne avokato per ceshtje ne gjykim.

Organi me i larte drejtues i shoqerise eshte asambleja e ortakeve . Ajo mblidhet nje here ne tre muaj , por edhe me shpesh ne rast se nje gje te tille e kerkon ndonjeri nga ortaket . Sa kohe qe te jene dy ortake eshte e detyrueshme prania e tyre ne cdo mbledhje te asamblese se shoqerise . Ajo ka te drejte te vendos per pjesemarrjen e shoqerise ne shoqeri te tjera , te ndryshoje ose te plotesoje statutin e saj , te miratoje bilancet vjetore te vleresuara nga organi i saj financier , si dhe te vendos per shperberjen e shoqerise ne rast falimentimi .

## EKSPERTI KONTABEL

## ARTIKULLI 17

Ortaket mund te caktojne edhe ekspert kontabel , qe te kontrolloje aktivitetin financiar , arken , regjistrin e veprimeve kontabel dhe te pergatis raportin perkates.

## BILANCI DHE TE ARDHURAT

## ARTIKULLI 18

SH.P.K. " Euron " Tirane çel llogarine e saj rrjedhese ...
re , por ajo nuk kufizohet te cele edhe llogari te tjera rrje...
ka te tjera te huaja gëpo vendase.

Veprimet ekonomike te shoqerise mbyllen me 3I dhjetor te ç...
Ne fund te çdo periudhe aprovet bilanci nga eksperti kontabel qe mira...ohe
nga ortaket e shoqerise .

Te ardhurat nekto pas veçimit te fondeve te nevojshme i mbeten or...
takeve te shoqerise , qe ndahet per zgjerimin e ka pitalit te shoqerise dh...
te fondeve te shoqerise dhe te ortakeve te saj.

## Ç M I M E T

## ARTIKULLI 19

Aktivitetin e saj SH.P.K. " Euron " Tirane do t'a zhvilloje kundrejt çmime...
ve , sipas kerkeses dhe ofertes , me perjashtim te rasteve qe jane caktuar
me vendim qeverie.

## SHPERBERJA E SHOQERISE

## ARTIKULLI 20

Shperberja e shoqerise mund te vije ne çdo kohe dhe per çdo lloj shkaku
si humbje kapitali, pamundesi veprimtarie , ose me vendim te ortakeve te
shoqerise . Ne kete rast ata caktojne nje ose me shume likuidatore dhe
vendosin per menyrat e likujdimit .

Administratoret dhe likujdatoret jane pergjegjes per ruajtjen e pasur...
se , shoqerore , perderisa t'u dorezohet personave perkatespersonat fizik e juridike , duke likujduar ne rradhe te pare detyrimet qe ka marre
shoqeria ndaj personave te trete.

Persa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete statut i referohet plo-
simeve qe do te bejne or taket e shoqerise si dhe me ligje te veçanta ne
fuqi. Ndryshimet dhe plotesimet ne kete statut behen ne te njejten menyre
dhe procedure ne te cilen aprovet statuti.

Sta tuti nenshkruhet rregullisht nga ortaket e shoqerise

ORTAKET E SH.P.K." EURON " TIRANE

( Gesim Çela ) ( Kujtim Shpati )

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
N O T E R I A TIRANE

NR. 484 REP.
NR. 263-570 KOL.

## V E R T E T I M

Ne Tira ne , sot me dt. 8-3 shkurt I994 ( nente dhjete e kater ...
u paraqiten ne zyren e noterise Tirane , z. Gesim Çela dhe Kujtim Shpati
me a dresat , gjeneralitet dhe leternjoftimet si me siper neartikullin 1
te ketij statuti , madhore , me zotesi te plote juridike te cilet deklarua...